



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 07 dhjetor 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi**

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Kolë Berisha, Adem Salihaj, Vladimir Todorović dhe Mufera Şinik.

Të pranishëm: Georgi Rupchev – EU – AC project, Shqipe Arifaj – Asociacioni i Komunave të Kosovës, Gëzim Bimbashi – BOOM TV, Lumnije Murati – ZPRK, Malva Govori – ECLO, Petrit Hysaj – OSBE, Blendi Gashi – Bota sot, Rrezarta Ahmeti – KDI, Saranda Rama – KTV, Mentor Borovci – AKK, Jetullah Aliu – AKK, Bedri Bahtiri – MD dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

**R e n d i i d i t ë s**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 26 tetorit 2009,
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
4. Të ndryshme.

Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i përshëndeti të pranishmit dhe mbikëqyrësit e punës së Komisionit. Propozoi të fillohet me rendin e ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 26 tetorit 2009

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryetari - Duke folur për Projektligjin tha se kemi mbajtur disa takime dhe dëgjime publike. Konsideroj se sot duhet ta përmbyllim dhe ta procedojmë me këto amendamente. Në mbledhjen e kaluar kemi pasur disa dilema se a duhet ta bëjmë publike pasurinë e zyrtarëve të lartë në faqen e internetit të Agjencisë, prandaj sot duhet të vendosim për këto dilema. Iu referua amendamentit 9, neni 12, Regjistri i deklarimit, parag. 3. Ky nen mbeti të diskutohet dhe të merret qëndrim, ndërsa paragrafët 5, 6 dhe 9 hiqen. Paragrafi 7 bëhet 5 dhe parag. 8 bëhet 6. Lidhur me këtë pikë hap debat.

Bajram Kosumi – Iu referua neni 12, parag. 3 dhe tha se mënyra e formulimit të këtij paragrafi jep t'i kuptojmë dy mënyra të qasjes në dokumentet zyrtare, që nuk janë qartësuar sa duhet. Pjesa e dytë e këtij formulimi: “Qasja në dokumentet e pasurisë mund të bëhet në bazë të procedurës së paraparë me Ligjin për qasjen në dokumentet zyrtare”. Ky formulim ose është mënyrë e dytë e qasjes, ose është në kundërshtim me pjesën e parë. Nëse është vetëm një mënyrë e qasjes ndaj dokumenteve zyrtare, duhet të hiqet kjo pjesë.

Selvije Halimi - Propozoi që paragrafi 3 i këtij neni të riformulohet: “Secili qytetar ose etnitet ka të drejtën e qasjes së lirë në deklarimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Qasja do të sigurohet në dy mënyra”:

“Me publikimin e deklarimit të pasurisë në faqen e internetit të Agjencisë” (teksti vazhdon si në propozimamendamentin 9),

“Qasja në deklarimet e pasurisë mund të bëhet edhe në bazë të procedurës” (formulimi vazhdon si në propozimamendamentin 9).

Armend Zemaj - Tha se edhe në grupin e punës kemi bërë përpjekje që këto dy mënyra të qasjes të ndahen. Fjalja “*Emrat e zyrtarëve të lartë publikë, që nuk e kanë deklaruar pasurinë, gjithashtu do të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë*”, nuk e ka vendin këtu, sepse është paraparë të sanksionohet në nenin 14, parag. 3. U pajtua me parafolësit që neni 12, paragrafi 3 të ndahet në dy pjesë. Ndërsa neni 12, paragrafi 9, duhet të mbetet si është, sepse publikimi në media është i lejuar vetëm me kusht që të publikohet e tërë deklarata.

Ibrahim Makolli - Tha se pjesa e dytë e parag. 3 është në kundërshtim me pjesën e parë, sepse në pjesën e parë lejohet qasja e papenguar, kurse në pjesën e dytë bazohemi në Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, që paraqet procedurë dhe formë krejt tjetër. Propozoi që pjesa e parë e paragrafit 3 të riformulohet si vijon: “*Deklaratat e pasurisë së*

*zyrtarëve të lartë publikë publikohen në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë*”. Tha se në media duhet të publikohet e tërë deklaratata.

Kryetari - Propozoi që ky paragraf të riformulohet si vijon: “Pasuria e zyrtarëve të lartë publikë publikohet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë. Agjencia obligohet që brenda periudhës dymujore, prej datës së pranimit të deklaratës, t’i publikojë të gjitha deklaratat e zyrtarëve të lartë publikë. Çdo qytetar ose etnitet ka të drejtë të ketë qasje në Regjistrin e deklarimit, duke u bazuar në Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.”

Nuk pati vërejtje për propozimin dhe mbeti të riformulohet siç u propozua, me ndonjë ndryshim teknik nga stafi i Komisionit.

Bedri Bahtiri - Propozoi që paragrafi i dytë i këtij propozimi të kalojë në dispozitat kalimtare, sepse bëhet fjalë për një periudhë kohe.

Adem Salihaj - Tha se paragrafi 9 nuk është i qartë sa duhet, sepse nuk dihet media apo Agjencia është e obliguar ta publikojë tërë deklaratën.

Ramadan Gashi - Propozoi që paragrafi 4 të riformulohet si vijon: ”Secili qytetar ose entitet ka të drejtë që me shkrim t’i paraqesë fakte dhe prova Agjencisë, e cila në bazë të tyre ndërmerr hetime për saktësinë e të dhënave të paraqitura në Regjistrin e deklarimit, kur kuptohet se informatat, që përfshihen në të, janë apo nuk janë të plota” dhe teksti më tutje vazhdon si në Projektligj.

Meqë pati diskutime për këta paragrafë, kryetari kërkoi nga anëtarët të deklarohen për propozimamendamentet, në të cilat me shumicë votash u hoqën paragrafët 5, 6 dhe 9, të nenit 12, ndërsa u miratuan propozimamendamenti 9, neni 11, paragr. 2.2, 2.5, 2.6 dhe 2.7.

Me amendamentet e miratuara nga Komisioni, Projektligji dërgohet për shqyrtim dhe miratim në një nga seancat e radhës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të ndryshme

*Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.*

Hartoi:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni